

160 KODI PËR ZONËN GJEORAFIKE

Fusha përmban kodet e zonave gjeografike për zonat gjeografike të lidhura me fushën 2XX.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
160	Kodi për zonën gjeografike	nr
a	<i>Kodi për zonën gjeografike</i>	r
b	<i>Kodi lokal për zonën gjeografike*</i>	r

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

160a Kodi për zonën gjeografike

Kodi tregon zonën gjeografike.

160b Kodi lokal për zonën gjeografike*

Kodi tregon zonën e ngushtë gjeografike brenda shtetit të caktuar në sistemin COBISS ose jashtë kufijve të tij.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Kodi përmban shtatë karaktere (shkronja dhe viza lidhëse) dhe mundëson ndarjen e entiteteve gjeografike e politike-territoriale.

Për kodim përdoret lista globale e kodeve të zonave gjeografike (*Shtojca B.1* me listën e emrave me renditje alfabetike ose *Shtojca B.2* me listën e kodeve me renditje alfabetike). Në nënfushën a vendosen kodet nga *MARC code list for geographic areas* (shih *Appendix D* të manualit *UNIMARC Manual. Bibliographic Format*), ndërsa në nënfushën b kodet nga lista lokale e kodeve, e cila përdoret në sistemin e caktuar COBISS.

SHEMBUJ

1.

160	uu	an-cn---
250	uu	a Canadian Grand Prix Race <i>(Shembull nga sistemi i huaj.)</i>

2.

160	uu	asa-----
215	uu	a Amazon River <i>(Shembull nga sistemi i huaj.)</i>

3. * COBISS.net

160	uu	ae-au---
215	uu	a Vjenë (Austria)

4. * COBISS.net

160	uu	amm-----
215	uu	a Mesdheu

5. * COBISS.net

160	uu	aea----- ae-xv--- ae-au---
215	uu	a Karavanke (Slovenia dhe Austria : vargmale) <i>(Për zonën gjeografike nuk ekziston kodi uniform, për këtë arsye duhet të përdoret kombinimi i disa kodeve.)</i>

6. *

160	uu	ae-xv--- be-xv-ok
215	uu	a Viadukt Črni Kal (Slovenija) <i>(Emri i objektit është në formën e emrit gjeografik. Objekti ndodhet në Slloveni dhe për këtë arsye është vendosur kodi nga lista lokale e kodeve për zonën gjeografike, në të cilën ndodhet objekti.)</i>

7. *

160	uu	ae-xv--- be-xv-jv be-xv-os
215	uu	a Dolenjska (Slovenija) <i>(Për zonën gjeografike brenda Sllovenisë në listen lokale të kodeve nuk ndodhet kodi uniform, për këtë arsye duhet të përdoret kombinimi i disa kodeve lokale.)</i>